



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2020:153358
Datë: 21.06.2024
Numri i dokumentit: 05847912

KPPP.nr.922/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti Për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Gent Bekeri, në çështjen juridike - përmbartimore të kreditorit Banka për Biznes (BPB), me numër të biznesit 70062470, me seli në Prishtinë, Rr."UÇK", 41, të cilin e përfaqëson Debt Loan Recovery sh.p.k, kundër debitorëve D.P.H "Nido" me numër të biznesit 80288875, me seli në Prishtinë, "Rruga e Mitrovicës", nr.3, N.P.T "Mika", me numër të biznesit 80149760, me seli në Prishtinë, Rr."Luan Haradinaj", nr.27 dhe V.D. nga Prishtina, "Rruga e Kaçanikut", nr.11, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr.187/20 të datës 29.09.2020 të Përmbartuesit Privat Sefer Sh.Arifi, jashtë seancës me datë 21.06.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

PRANOHET si i bazuar prapësimi i debitorit N.P.T "Mika", me numër të biznesit 80149760, me seli në Prishtinë, Rr."Luan Haradinaj", nr.27, ANULOHET urdhri përmbartimor P.nr.187/20 i datës 29.09.2020, i lejuar nga Përmbartuesi Privat Sefer Sh.Arifi, me seli në Gjilan.

A r s y e t i m

Përmbartuesi Privat, duke vepruar sipas plotësimit të propozimit të kreditorit Banka për Biznes (BPB), me seli në Prishtinë, Rr."UÇK", 41, ka lëshuar urdhrin përmbartimor P.nr.187/20 të datës 29.09.2020, me të cilin ka lejuar përmbartimin, në bazë të Aktgjykimit të Gjykatës Ekonomike të Qarkut në Prishtinë me numër I.C.nr.24/2009 të datës 12.02.2009, ashtu që ka caktuar përmbartimin ndaj debitorëve D.P.H "Nido", N.P.T "Mika" dhe V.D., t'ia paguaj borxhin në shumë prej 3,072.10€, në afat prej 7 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit, si dhe shpenzimet e procedurës përmbartimore në pajtim me UA-MD-së nr.06/2014 dhe të gjitha shpenzimet e përmbartuesit privat, nën kërcënim të përmbartimit me dhunë.

Kundër urdhrit për lejimin e përmbarimit brenda afatit ligjor debitori N.P.T “Mika” ka paraqitur prapësim në të cilin ka deklaruar se propozimi për përmbarim duhet të refuzohet sepse i njëjti ka të meta në përmbajtje dhe se urdhri i lejuar nga ana e organit përmbarues është dërguar në bazë të dokumentit të besueshëm, e sipas dispozitave të Ligjit për Procedurën Përmbarimore, përkatësisht nenit 22 dhe 23 aktgjykimi konsiderohet si dokument përmbarues, andaj ka qenë detyrë e organit përmbarues që të udhëzoj palët për ndryshimet e nevojshme formale. Më tej ka theksuar se e drejta e kreditorit për të kërkuar këtë detyrim nuk mund të kërkohet në rrugë ligjore sepse për të njëjtin ka kaluar koha e paraparë ligjore, pra është parashkruar. Duke u mbështetur në nenin 341, par.1 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve si dhe në lidhje me nenin 361, par.1 të po të njëjtit ligj, aktgjykimi i paraqitur si dokument përmbarues C.nr.24/2009 është nxjerrë me datë 12.02.2009, andaj kërkesa si e tillë e vërtetuar me vendim të formës së prerë të gjykatës është parashkruar dhe kreditori nuk mund të kërkojë të drejtën e saj në rrugë ligjore pasi që urdhri për përmbarim është lejuar me datë 29.09.2020. Po ashtu, duke qenë se nuk ka pasur ujdi gjyqësore për pagesë periodike me këste, çdo pagesë periodike në të ardhmen apo çdo kërkesë për një gjë të tillë nuk e ndalon parashkrimin e aktgjykimit. I ka propozuar gjykatës që të pranojë prapësimin e debitorit dhe të obligohet kreditori që të paguajë shpenzimet e procedurës përmbarimore.

Kreditori, në afatin e paraparë ligjor ka parashtruar përgjigje në prapësim, duke kundërshtuar urdhërin përmbarimor në bazë të të cilit është lejuar propozimi për përmbarim. Më tej ka theksuar se procedura përmbarimore është filluar në bazë të aktgjykimit të Gjykatës Ekonomike të Qarkut në Prishtinë me numër I.C.nr.24/09 të datës 12.02.2009. Pretendimi i debitorit për parashkrim është i paqëndrueshëm duke ditur që të drejtat dhe obligimet nga vendimet e gjykatës në lëmin civile parashkruhen pas 10 viteve nga plotfuqishmëria e tyre në rast se nuk ndërmerren veprime konkrete ligjore për realizimin e tyre. Debitori do të mund të thirrej në parashkrim në rast se kreditori nuk do të fillonte asnjë procedurë për realizimin e të drejtës së vet në afat prej 10 vitesh pas datës 21.01.2010 kur edhe është bërë i plotfuqishëm Aktgjykimi i Gjykatës Ekonomike të Qarkut në Prishtinë me numër I.C.nr.24/09 të datës 12.02.2009, ku kreditori e ka iniciuar procedurën përmbarimore në Gjykatën Komunale në Prishtinë me datë 08.07.2010. Më tej ka theksuar se si dëshmi tjetër që nuk ka parashkrim është edhe fakti që debitori B.I. me datë 22.03.2011 ka bërë një pagesë (deponim) në shumë prej 200€, me datë 24.04.2011 pagesën në shumë prej 200€, si dhe me datë 30.09.2020 ka bërë pagesën në shumë prej 100€, dhe se në një takim të mbajtur janë pajtuar që të arrijnë një marrëveshje për

pagesën e borxhit, kështu duke shprehë keqardhje se për shkak të problemeve shëndetësore dhe financiare nuk ka mundur që ta përmbushë borxhin sipas aktgjykimit të Gjykatës Ekonomike të Qarkut në Prishtinë me numër I.C.nr.24/09 të datës 12.02.2009. I ka propozuar Gjykatës që të refuzohet si i pa bazë prapësimi i ushtruar nga ana e debitorit si dhe të lejohet urdhri për përmbarim P.nr.187/20 i datës 29.09.2020 dhe të vazhdohet me procedurën përmbarimore deri në përmbushjen e tërësishme të obligimit.

Gjykata Komerciale e Kosovës- Dhomat e Shkallës së Parë, lidhur me këtë çështje përmbarimore me Aktvendimin KPPP.nr.590/22 të datës 23.10.2023, prapësimin e debitorit e ka aprovuar si të bazuar dhe urdhrin përmbarimor P.nr.187/20 të datës 29.09.2020, e ka anuluar.

Gjykata Komerciale e Kosovës - Dhomat e Shkallës së Dytë, me Aktvendimin K.DH.SH.II.nr.69/24 të datës 24.05.2024, ka aprovuar si të bazuar ankesën e kreditorit, duke prishur Aktvendimin KPPP.nr.590/22 të datës 23.10.2023, të Gjykata Komerciale e Kosovës-Dhomat e Shkallës së Parë, dhe lëndën e ka kthyer në rishqyrtim dhe rivendosje.

Gjykata në ri procedurë duke vepruar sipas sugjerimeve dhe vërejtjeve të Gjykatës Komerciale të Kosovës - Dhomave të Shkallës së Dytë, e pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, kundërshtimeve të kreditorit nga përgjigjja në prapësim, duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligjit Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarimore, (tutje LPP), dhe nenit 12 par. 2 të Ligjit Nr. 05/L-118 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-139 Për Procedurën Përmbarimore, gjeti se prapësimi i debitorit është i bazuar dhe se urdhri përmbarimor duhet të anulohet, për shkaqet si në vijim:

Organi përmbarues ka lejuar përmbarimin mbështetur në nenin 21 të LPP-së i cili përcakton se: *“Organi përmbarues e cakton, përkatësisht e zbaton përmbarimin vetëm në bazë të dokumentit përmbarues (titulus executionis) dhe dokumentit të besueshëm, po qe se me këtë ligj nuk është parashikuar diçka tjetër.”*, neni 22 par.1 pika 1.1 përcakton se *“vendimi përmbarues i Gjykatës dhe ujdia (pajtimi) gjyqësore përmbaruese.”* si dhe neni 23, par.1 përcakton se *“sipas këtij ligji, vendim gjyqësor konsiderohet aktgjykimi, aktvendimi, si dhe vendimi tjetër i dhënë në procedurën gjyqësore ose të arbitrazhit, kurse ujdi gjyqësor konsiderohet ujdia e arritur përpara Gjykatës dhe arbitrazhit si dhe marrëveshja e arritur në procedurën e ndërmjetësimit”*, ndërsa me nenin 36 par.1 të LPP-së, përcaktohet se: *“Së bashku*

me propozimin për përmbarrim, organit përmbarrues i dorëzohet edhe dokumenti përmbarrues, origjinal apo kopje e vërtetuar, me klauzolën e përmbarrueshmërisë për përmbarrueshmëri”.

Gjykata duke u bazuar në të lartcekurat, gjeti se Aktgjykimit të Gjykatës Ekonomike të Qarkut në Prishtinë me numër I.C.nr.24/2009 të datës 12.02.2009, në bazë të cilit është mbështetur propozimi për përmbarrim dhe është lejuar urdhri përmbarrimor është bashkëngjitur në kopje, ndërsa në shkresat e lëndës nuk është deponuar origjinali apo kopja e vërtetuar siç kërkohet me nenin 36 të LPP-së.

Nga të lartcekurat rezulton se propozimi për përmbarrim mbi bazën e të cilit është lejuar urdhri, përmban të meta ngase në propozim nuk janë treguar dokumentet origjinale apo kopje e vërtetuar mbi bazën e të cilëve është iniciuar procedura përmbarrimore, ashtu siç përcaktohet edhe me dispozitën nga neni 38, paragrafi 1 të LPP-së: *“Propozimi për përmbarrim duhet ta përmbajë kërkesën për përmbarrim në të cilën do të tregohet dokumenti përmbarrimor origjinal apo kopje e vërtetuar, apo dokumenti i besueshëm..”*, andaj u vendos që urdhri për lejimi e përmbarrimit të anulohet.

Gjykata vlerësoi pretendimet e debitorit sa i përket parashkrimit të kërkesës, por të njëjtin nuk e mori për bazë nga se aktgjykimi i Gjykatës Ekonomike të Qarkut në Prishtinë me numër I.C.nr.24/09 është nxjerrë me datë 12.02.2009, ku i njëjti aktgjykim është bërë i plotfuqishëm me datë 21.01.2010, ndërsa propozimi për përmbarrim është paraqitur me datë 08.07.2010, në Gjykatën Komunale në Prishtinë e më pastaj është deleguar për trajtim tek përmbarruesi Privat me datë 17.09.2020, nga kjo rezulton që propozimi për përmbarrim është paraqitur në po të njëjtin vit kur edhe është bërë i plotfuqishëm.

Gjykata vlerësoi edhe pretendimet tjera të palëve të paraqitura në prapësim dhe përgjigje në prapësim, mirëpo të njëjtat nuk ishin relevante për këtë çështje përmbarrimore.

Nga arsyet e paraqitura më lart dhe duke u bazuar në nenin 73 të LPP-së, nenin 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti i Përgjithshëm

KPPP.nr.922/24, datë 21.06.2024

Gjyqtari

Gent Bekeri

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimi të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerçiale, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.